

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar
Advanced Financial Reporting

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
14.01.2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Draft pasqyrat financiare në vijim kanë të bëjnë me kompanitë e listuara publikisht, Dimri, Bredhi, Bora dhe Festa:

Draft pasqyrat e pozitës financiare me 30 qershor 2016:

	Dimri € milion	Bredhi € milion	Bora € milion	Festa € milion
Pasuritë jo-qarkulluese				
Prona, fabrika dhe paisjet	130	110	119	90
Pasuritë e paprekshme	5			10
Investimet:				
Bredhi	100			
Bora	60	40		
Pasuritë qarkulluese	<u>58</u>	<u>56</u>	<u>34</u>	<u>49</u>
Total pasuritë	353	206	153	149
Ekuiteti dhe detyrimet				
Aksionet e ekuitetit €1 secila	240	125	80	80
Komponentë të tjetër të ekuitetit	7	10		
Fitimet e mbajtura	41	31	49	46
Detyrimet afatgjata	20	10	15	5
Detyrimet afatshkurtëra	<u>45</u>	<u>30</u>	<u>9</u>	<u>18</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	353	206	153	149

Draft pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar 30 qershor 2016

	Dimri € milion	Bredhi € milion	Bora € milion	Festa € milion
Të hyrat	250	180	125	80
Kosto e shitjeve	<u>(80)</u>	<u>(60)</u>	<u>(40)</u>	<u>(34)</u>
Fitimi bruto	170	120	85	46
Të hyrat tjera	2	3	-	-
Shpenzimet operative	<u>(68)</u>	<u>(47)</u>	<u>(29)</u>	<u>(15)</u>
Fitimi para tatimit	104	76	56	31
Tatimi	<u>(25)</u>	<u>(16)</u>	<u>(10)</u>	<u>(5)</u>
Fitimi për vitin	79	60	46	26
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin (neto nga tatimi)	5	4	-	-
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	84	64	46	26

Informata shitesë:

1. Dimri bleu 60% të aksioneve të ekuitetit në Bredhi me 1 korrik 2013 kur fitimet e mbajtura të Bredhit ishin €9 milion dhe komponentët tjerë të ekuitetit ishin €6 milion. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Bredhi ishte €80 milion në datën e blerjes. Vlerat e drejta të neto pasurive të Bredhit ishin përafërsisht të barabarta me vlerat e tyre bartëse me perjashtim të disa pronave. Në atë datë, këto prona kishin vlerë të drejtë prej €8 milion më të lartë se vlera bartëse dhe jete të mbetur të përdorimit prej 5 viteve. Këto shuma nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare të Bredhit me 30 qershor 2016.

2. Bredhi bleu 60% të aksioneve të ekuitetit në Bora me 1 korrik 2015 kur fitimet e mbajtura ishin €3 milion. Në të njejtën datë, Dimri gjithashtu bleu 30% të aksioneve të ekuitetit në Bora. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Bora në datën e blerjes ishte €40 milion. Vlerat e drejta të pasurive neto ishin përafërsisht të barabarta me vlerat bartëse.

3. Me 1 janar 2016, Dimri bleu 40% të aksioneve të ekuitetit të Festa nëpërmjet një emetimi prej 2 aksioneve për çdo 4 aksione të blera. Ky transaksion nuk është regjistruar nga Dimri. Çmimi i tregut të aksioneve të Dimrit dhe Festës ishin €3 dhe €2 për aksion, respektivisht.

4. Gjatë gjysmës së dytë të vitit financiar, Bredhi shiti mallra tek Dimri për €10 milion. Fitimi i Bredhit në këtë shitje ishte €3 milion. Gjysma e këtyre mallrave kanë mbetur në stoqet e Dimrit. Dimri gjithashtu shiti mallra me kosto €1 milion me një marzhë mbi kosto prej 25% tek Festa në vitin 2016. Këto mallra mbeten pa u shitur dhe janë përfshirë në stoqet në fund të Festës.

5. Nuk ka pasur emetim të aksioneve në grup që nga 1 korrik 2015. Zëri i mirë është testuar për dëmtim me 30 qershor 2016 dhe kishte humbje nga dëmtimi prej €3 milion dhe €2 milion për Bredhi dhe Bora respektivisht. Investimi në Festa ishte dëmtuar për €0.28 milion.

6. Gjatë vitit, dividendët në vijim janë propozuar dhe deklaruar:

Dimri: 5% (duke përjashtuar aksionet e emetuara në vitin aktual)

Bredhi: 3%

Bora: 3%

Dividendat e mësipërme nuk janë regjistruar në libra dhe janë si përqindje e vlerës nominale

7. Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë në datën e blerjes. Injoro efektet e tatimit.

Kërkohet:

Përgadite pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjës dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare për grupin Dimri me 30 qershor 2016.

(25 pikë)

1. Blerja e Dimri në Bredhi me 1 korrik 2013

		Prindi € milion	IJK € milion	Total € milion
Konsiderata e transferuar		100		100
VDIJK në datën e blerjes			80	80
VDPN në datën e blerjes:				
Ekuiteti	125			
Fitimet e mbajtura	9			
VD korrigjimet	8			
KTE	<u>6</u>			
	148	<u>(88.8)</u>	(59.2)	<u>(148)</u>
Zëri i mirë		11.2	20.8	32
Dëmtimi i zërit të mirë		<u>(1.8)</u>	<u>(1.2)</u>	<u>(3)</u>
		9.4	19.6	29

Blerja e Bora me 1 korrik 2015

		Prindi € milion	IJK € milion	Total € milion
Konsiderata e transferuar				
- Direkt		60		
- Indirekt 40 x 60%		<u>24</u>		84
VDIJK në datën e blerjes			40	40
VDPN në datën e blerjes:				
Ekuiteti	80			
Fitimet e mbajtura	<u>3</u>			
	83	(54.78)	(28.22)	(83)
Zëri i mirë		29.22	11.78	41
Dëmtimi i zërit të mirë		<u>(1.32)</u>	<u>(0.68)</u>	<u>(2)</u>
		27.9	11.1	39

Investimet në Festa me 1 janar 2016	€ milion
Konsiderata e transferuar:	48
Pjesa e fitimeve pas blerjes: 26 x 6/12 x 40%	5.2
Dëmtimi	(0.28)
FPR 1/125 x 25 x 40%	<u>(0.08)</u>
Vlera bartëse e investimeve në ortakëri	52.84

Analiza e fitimeve të mbajtura

	Dimri	Bredhi	Bora	Festa
	€ milion	€ milion	€ milion	€ milion
Saldo në fillim	41	31	49	46
Fitimet para blerjes		<u>(9)</u>	<u>(3)</u>	<u>(33)</u>
Fitimet pas blerjes		22	46	13
FPR	(0.08)	(1.5)		
Zhvlerësimi : 1.6 x 3 vite		(4.8)		
Dividendat e propozuara	(12)	(3.75)	(2.4)	
Dividendat e arkëtueshme :				
Nga Bredhi 3.75 x 60%	2.25			
Bora 2.4 x 30%	0.72			
2.4 x 60%		1.44		
Dëmtimi i zërit të mirë:				
Bredhi	(1.8)			
Bora	(1.32)			
Dëmtimi i investimit në Festa	(0.28)			
Fitimet pas blerjes		13.39	43.6	13
Pjesa e fitimeve pas blerjes:				
Bredhi 13.39 x 60%	8.034			
Bora 43.6 x 66%	28.776			
Festa 13 x 40%	<u>5.20</u>			
Tek PKPF	70.5			

IJK - Bredhi 40%	€ milion
VDIJK në datën e blerjes	80
Pjesa e fitimeve pas blerjes: 13.39 x 40%	5.356
KTE	1.6
Dëmtimi i zërit të mirë	(1.2)
Investimet indirekte 40 x 40%	<u>(16)</u>
Tek PKPF	69.756

IJK - Bora 34%

€ milion

VDIJK në datën e blerjes	40
Pjesa e fitimeve pas blerjes: 43.6 x 34%	14.824
Dëmtimi i zërit të mirë	<u>(0.68)</u>
Tek PKPF	54.144

Analiza e KTE

	Dimri € milion	Bredhi € milion
Saldo fillestare	7	10
Para blerjes		<u>(6)</u>
Pjesa pas blerjes		4
4 x 60%	<u>2.4</u>	
Tek PKPF	9.4	

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të grupit Dimri me 30 qershor 2016

	€ milion
PPF 130 + 110 + 119 + VD 8 - zhvlerësimi 4.8	362.2
Zëri i mirë 39 + 29	68
Investimet në ortakëri	52.84
PP	5
PQ 58 + 56 + 34 - 1.5	146.5
Total pasuritë	634.54
Ekuiteti 240 + aksionet e emetuara 16	256
Premia e aksioneve	32
Komponentë të tjetër të ekuitetit 7 + 2.4	9.4
Fitimet e mbajtura	70.5
IJK 69.756 + 54.144	123.9
Detyrimet afatgjata 20 + 10 + 15	45
Detyrimet afatshkurtëra 45 + 35 + 9	84
Dividendat e propozuara -Dimri	12
Dividendat tek IJK 3.75 x 40% + 2.4 x 10%	1.74
Total ekuiteti dhe detyrimet	634.54

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar 30 qershor 2016

	€ milion
Të hyrat 250 + 180 +125 -10	545
KSH (80 + 60 + 40 - 10 + FPR 1.5 + FPR zhvleresimi 1.6	<u>(173.1)</u>
Fitimi bruto	371.9
Të hyrat tjera 2 + 3	5
Shpenzimet operative 68 + 47 + 29 + dëmtimi i zërit te mirë 3 + 2	(149)
Pjesa e fitimit neto të ortakërisë 26/2 x 40% - dëmtimi i zërit te mirë 0.28- FPR 0.08	<u>4.84</u>
Fitimi para tatimit	232.74
Tatimi (25 + 16 + 10)	<u>(51)</u>
Fitimi për vitin	181.74
TTGJ 5 + 4	9
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	190.74

	€ milion
Fitimi për vitin i atribuar:	
IJK : Bredhi 60 - 1.5(FPR) - 1.6 (Zhvlersimi) - dëmtimi i zërit te mirë 3 x 40%	21.56
Bora 46 - dëmtimi i zërit te mirë 2 x 34%	14.96
Prindi	<u>145.22</u>
	181.74

	€ milion
Total fitimi ose humbja dhe të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse atribuar:	
IJK : Bredhi 64 -1.5 (FPR) - 1.6(Zhvlersimi)) - dëmtimi i zërit te mirë 3 x 40%	23.16
Bora 46 - dëmtimi i zërit te mirë 2 x 34%	14.96
Prindi	<u>152.62</u>
	190.74

	€ milion
Fitimet e mbajtura në fillim	
Dimri	(38)
Bredhi (29 - para blerjes [9] - Zhvl. [1.6 x 2] x 6%	(24.72)
Vitimi i vitit	145.22
Dividenda (Dimri)	<u>(12)</u>
Fitimet e mbajtura në fund	70.5

Problemi 2

a) SNRF 2 'Pagesat e bazuara në aksione' mbulon kryesisht kontabilitetin për transaksionet e pagesave që shlyhen me para dhe që shlyhen me ekuitet. Pagesat e bazuara në aksione janë shfaqur si mënyrë për të motivuar punonjësit dhe të rritet performanca e përgjithshme e kompanisë.

Banka sh.a vendosi të fus një skemë të lidhur me performancën që do të bëhej efektive nga data 1 janar 2016. Kushtet e skemës ishin si në vijim:

- 20 prej punëtorve të saj do të kishin të drejtën e 1,000 aksioneve të ekuitetit secili.
- Kompania do t'i jepte secilit punëtor detyrimisht para për gjashtëdhjetë përqind të aksioneve për të cilat ata kanë të drejtë. Paraja do të bazohej në vlerën e tregut të këtyre aksioneve me 31 dhjetor 2018.
- Pjesa e mbetur e aksioneve që ju takojnë punëtorve do të ju emetohet punëtorve me 1 janar 2018.
- Vetëm punëtorët që do të mbesin në kompani deri me 31 dhjetor 2018 do të kenë të drejtën për t'i pranuar paratë dhe përfituar aksionet sipas skemës.

Kompani ka pritur që një punëtor do të largohet deri me 31 dhjetor 2018. Gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2016, një punëtor u largua nga kompania. Megjithatë, drejtorët e Banka sh.a nuk presin që ndonjë punëtor tjetër të largohet nga kompania deri me 31 dhjetor 2018.

Informatat më poshtë janë të rëndësishme

Data	Vlera e tregut për aksion
1 janar 2016	€15.00
31 dhjetor 2016	€16.00
31 dhjetor 2017	€17.00 Parashikim
31 dhjetor 2018	€20.00 Parashikim

Kërkohet:

- (i) Shpjego se si transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me para dhe transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet kontabilizohen në pasqyrat financiare të një entiteti. (4 pikë)
- (ii) Shpjego se si transaksioni mësipër duhet të kontabilizohet në pasqyrat financiare të Banka sh.a për vitin deri me 31 dhjetor 2016. (6 pikë)

b) T-Rex sh.p.k huazoi €800,000 me 1 janar 2016 nga Betabank me një interes në kredi prej 10% në vit. Kredia ishte për ndërtimin e ndërtesës së zyreve. Ndërtimi filloi 1 prill 2016 dhe ka gjasa të përfundoj me 31 mars 2018. Me 30 shtator 2016, punët e ndërtimit janë pezulluar për shkak të një greve të punëtorve të ndërtimit. Megjithatë, punët e ndërtimit rifilluan me 1 janar 2017.

Shënim: Interesi për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 është paguar.

Kërkohe:

Shpjego trajtimin në kontabilitet të kostove të interesit në pasqyrat financiare të T-Rex sh.p.k për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016. (5 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

(i) Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me para dhe transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet

Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me para njihen në pasqyrën e pozitës financiare si detyrim dhe levizjet në shumën e detyrimit dërgohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Detyrimi vlerësohet sipas shumës së parasë që pritet të paguhet baza e së cilës është vlera e tregut e secilit opcion.

Transaksionet që shlyhen me ekuitet në anën tjetër njihen tek ekuiteti dhe levizjet në vlerën e tyre dërgohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse tek shpenzimet. Transaksionet që shlyhen me ekuitet vlerësohen duke u bazuar në aksionet që pritet të përfitojnë titullin duke përdorur vlerën e tregut të secilit opcion në datën e akordimit. Kur aksionet emetohen në këmbim të një pasurie p.sh ndërtesë ose stoqe, entiteti nuk mundet në mënyrë të besueshme të masë vlerën e aksioneve, atëherë vlera e drejtë e pasurisë së përvetsuar duhet të përdoret për të vlerësuar aksionet që emetohen.

(ii) Skema e lidhur me performancën e ofruar nga Banka sh.p.k ka edhe transaksione që shlyhen me para edhe transaksione që shlyhen me ekuitet. Transaksionet që shlyhen me para duhet të vlerësohen duke u bazuar në çmimin e tregut për aksion në datën e raportimit dhe numrin e aksioneve që pritet të ju emetohen punëtorve. Në mënyrë alternative, pjesa e ekuitetit e skemes duhet të vlerësohet duke u bazuar në çmimin e tregut për aksion në datën e akordimit dhe numrin e aksioneve për të cilat pritet të përfitohet titulli.

Banka sh.a andaj do të njohë total shpenzime prej €98,800 (60,800L11+38,000L12) në pasqyrën e saj të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016. Për më tepër, një detyrim prej €60,800 L11 dhe një ekuitet prej €38,000 do të njihet në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2016 sa i përket transaksionit për pagesën e bazuar mbi aksione që shlyhet me para dhe transaksionit për pagesën e bazuar mbi aksione që shlyhen me ekuitet respektivisht.

Llogaritjet

L11 Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me para

	Detyrimi	Shpenzimi
	000	000
60% x 1,000 aksione x (20 - 1) x 16€ x 1/3	60,800	60,800

L12 Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet

	Ekuiteti	Shpenzimi
	000	000
40% x 1,000 aksione x (20 - 1) x 15€ x 1/3	38,000	38,000

b) SNK 23 'Kostot e huamarrjes' shpjegon se kur duhet të filloj dhe përfundoj kapitalizimi i kostove të huamarrjes. Kapitalizimi fillon kur:

- Aktivitete e lidhura direkt me ndërtimin e pasurisë së kualifikuar kanë filluar.
- Shpenzimet për pasurinë kanë ndodhur.
- Kostot e interesit janë shkaktuar

Megjithatë, kapitalizimi duhet të pezullohet kryesisht kur aktivitetet e lidhura direkt me ndërtimin e pasurisë janë:

- Ndërprerë
- Përfunduar
- Shtyrë ose
- Pasuria është e gatshme për përdorim

Në rastin e T-Rex sh.p.k, interesi në total për vitin e përfunduar me 31 dhjetor arriti shumën prej €80,000 (10% x €800,000). €40,000 (6/12 x €80,000) duhet të kapitalizohet pasi që është shkaktuar kur aktivitetet e lidhura me ndërtimin e ndërtesës për zyre kanë filluar. Megjithatë, €40,000 (6/12 x €80,000) duhet të shpenzohen pasi që kanë të bëjnë me periudhën kur ndërtimi nuk ka filluar, janar 2016 deri me 31 mars 2016, dhe kur aktivitetet që kanë të bëjnë me ndërtimin janë pezulluar nga 1 tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016.

Problemi 3

(a) Gjatë vitit të përfunduar me 30 qershor 2016, Bizoni sh.p.k kishte këto transaksione:

- i) Në korrik 2015, Bizoni sh.p.k. bleu një ndërtesë për €3 milion me një jetë të vlerësuar të përdorimit prej 40 viteve. Është politikë e kompanisë të zhvlerësoj ndërtesën në baza drejtvizore. Me 30 qershor 2016, ndërtesa është rivlerësuar në €3.5 milion. Është politikë e kompanisë të ngarkoj zhvlerësimin e tërë vitit në vitin e blerjes dhe të mos ngarkoj zhvlerësim në vitin e shitjes. Për qëllime të tatimit, një lejim fillestar prej 10% dhe një lejim vjetor prej 5% jipen për ndërtesat e tilla. Kompania nuk ka qëllim ta shëse ndërtesën e rivlerësuar.
- ii) Kosto të hulumtimit prej €100,000 janë shlyer tek fitimi ose humbja, përderisa kostot e zhvillimit prej €450,000 që përmbushin kriteret për kapitalizim janë njohur si pasuri, por jo për qëllime tatimore.
- iii) Bizoni sh.p.k. kishte të arkëtueshme tregtare prej €500,000 dhe një lejim për borxhe të dyshimta prej 10% është bërë gjatë vitit. Lejimet nuk janë lejuar për qëllime tatimore këtë vit dhe janë diferencë e përkohshme.

Norma e tatimit në fitim është 25% për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016.

Kërkohet:

a) **SNK 12 Tatimi në të ardhura** kërkon që pasuri dhe detyrime të tatimit të shtyrë të njihen për të gjitha diferencat e përkohshme. Shpjego shkurtimisht diferencat e përkohshme. (3 pikë)

b) Llogarit pasurinë e tatimit të shtyrë apo detyrimet e tatimit të shtyrë me 30 qershor 2016 që rrjedhin nga transaksionet e mësipërme. (7 pikë)

c) Punëtorët permanent të Holiday kanë të drejtën e pushimit me pagesë prej 30 diteve çdo vit dhe pushimi përlllogaritet në mënyrë të njëtrajtshme çdo vit si dhe pushimi i papaguar mund të bartet përpara vëtëm për një vit. Viti i pushimit është në harmoni me vitin financiar. Me 31 mars 2016 Enil kishte 1500 punëtor. Pushimi mesatar i pashfrytëzuar është 5 ditë për punëtor. Në datën e raportimit është vlerësuar se 5% e punëtorve do të largohen pa e marrë këtë pushim që iu takon. Punëtorët që largohen do të paguhen me para në vend të pushimit. Jane 225 ditë pune gjatë vitit. Kosto e pagave vjetore totale është €45 milion.

Kërkohet:

Diskuto se si transaksioni i mësipërm duhet të kontabilizohet në pasqyrat financiare të Enil me 31 mars 2016.

(5 pikë)

(d) Gjatë vitit të përfunduar me 30 shtator 2015 Alberta sh.p.k furnizoi një klient me një produkt i cili rezultoi të jetë me defekt. Kjo bëri që klienti të ketë humbje financiare dhe klienti ka bërë padi kundër Alberta sh.p.k për humbjen e shkaktuar. Padia ende nuk është paguar por duket se Alberta sh.p.k do të duhet të bëjë një pagesë prej €24 milion për të paguar padinë diku në janar 2016. Alberta sh.p.k ka investiguar shkaktarin e defektit dhe doli që ka të bëjë me një pjesë me defekt që i është furnizuar nga një furnitor i saj. Departamenti ligjor i Alberta sh.p.k ka për qëllim të bëjë një kundër padi për €24 milion kundrejt furnitorit ashtu që në fund në të jetë në përgjithësi e kompenzuar. Alberta sh.p.k mendon që për këtë gjë do të duhen diku katër muaj. Alberta sh.p.k supozon që asgjë nuk duhet të regjistrohet pasi që është e mbuluar, por a duhet të bëjë ndonjë shpalosje?

Kërkohet:

Drafto një përgjigje për pyetjen e ngritur. Përgjigja e juaj duhet të përfshijë shpjegime shtesë të cilat ju i konsideroni relevante. Ju duhet të llogaritni impaktin në fitimet e raportuara për vitet e përfunduara me 30 shtator 2015 dhe 2016.

(5 pikë)

(Total: 20 pikë)

3

a)

Bazuar në SNK 12, diferencat e përkohshme janë diferencat ndërmjet vlerës bartëse të një pasurie ose detyrimi në pasqyrën e pozitës financiare dhe bazës së saj tatimore.

Diferencat e përkohshme mund të jenë një diferencë e përkohshme e tatueshme (DPT) ose një diferencë e përkohshme e zbritshme (DPZ). Standardi kërkon që një detyrim i tatimit të shtyrë duhet të regjistrohet për DPT dhe një pasuri e tatimit të shtyrë duhet të njihet për DPZ.

b)

Transaksioni	Vlera bartëse	Baza tatimore	DPT	DPZ
	€	€	€	€
Ndërtesat	3,000,000	3,000,000		
Zhvlerësimi i akm 3,000,000 / 40	(75,000)			
Lejimi fillestar 10% * 3,000,000		(300,000)		
Lejimi vjetor 5%*3,000,000		(150,000)		
Teprica në rivlerësim 3,500,000 – 2,925,000	575,000	-		
VB me 30 qershor 2016	3,500,000	2,550,000	950,000	
Kosto e hulumtimit dhe zhvillimit	450,000	-	450,000	
Të arkëtueshmet tregtare	500,000	500,000		
Borxhet e dyshimta 10%*500,000	(50,000)	-		
VB me 31 dhjetor 2015	450,000	500,000		50,000
			1,400,000	50,000
Neto DPT		1,350,000		
Dteyrimet e tatimit të shtyrë @ 25%		337,500		

c) Në datën e raportimit të gjithë 1500 punëtorët janë prezent dhe kanë të drejtën të kompenzohen për pushimin që nuk është shfrytëzuar dhe që lejohet të akumulohet. Ky pushim është përfitim afatshkurtës i punëtorve siç është definuar me SNK 19 (2011).

- Total kostoja e përfitimit duhet të përlllogaritet në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2016. Pritjet që 5% e punëtorve mund të largohen pa e shfrytëzuar në tërësi pushimin që ju takon është jo materiale në krahasim me shumën që njihet si një akruale sepse i) nëse punëtori largohet pas periudhës raportuese nuk do të jetë një ngjarje korrigjuese sepse kjo ngjarje nuk do të ndikoj në kushtet që kanë ekzistuar në datën e raportimit ii) dhe pasi që punëtorët paguhen prapë së prap për pushimin e pashfrytëzuar, shuma e akrualeve është e paafektuar edhe nese punëtori qendron deri sa ti shfrytëzon ditët e pushimit ose largohen para se ta përdorin në tërësi pushimin që ju takon.

- Si rrjedhojë, shuma totale prej €1m duhet të përlllogaritet; duke njohur një detyrim afatshkurtër dhe një shpenzim tëk fitimi ose humbja për shumën e njejtë në pajtim me SNK 19 (2011).

Llogaritjet:

Akrualet per pagesen e pushimit

Kostot vjetore të pagave	€45,000,000	
Numri i ditëve të pashfrytëzuar të pushimit 5 x 1,500	7,500	Kompenzimi
Numri i ditëve gjatë vitit 1,500 x 225	337,500	
Pagesa për ditë €45m/337,500	133.33	
Pagesa për 7,500 ditë	€1,000,000	Kosto e kompenzimit të pushimit të pashfrytëzuar

d) Është e domosdoshme që të konsiderohen të dy pjesët e çështjes ndarazi. Kërkesa nga klienti ynë duhet të njihet si detyrim (provizion) në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 30 shtator 2015. SNK 37 - *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente* - thotë që një provizion duhet të bëhet në datën e raportimit kur:

- (i) Entiteti ka një obligim të tanishëm që rrjedh nga ngjarjet e kaluara
- (ii) Ka gjasa të daljes së përfitimeve ekonomike
- (iii) Shuma mund të matet me nesueshmëri.

Që të tri kushtet përmbushen këtu dhe duhet të behët një provizion prej €24m, me një shpenzim korespondues në fitim ose humbje. Kundër kërkesa ndaj furnitorit tonë është një pasuri kontigjente. SNK 37 thotë që pasuritë kontigjente nuk duhet të njihen deri sa realizimi i tyre të jetë virtualisht i sigurtë, por duhet të shpaloset kur realizimi i tyre ka gjasa. Mesa duket kështu është situata këtu. Andaj pasuria kontigjente duhet të shpaloset në një shënim në pasqyrat financiare të vitit 2015 dhe duke supozuar që realizimi do të ndodh siq pritet të njihet si e ardhur në pasqyrat financiare të vitit 2016.

Problemi 4

Shumë standarde të kontabilitetit kërkojnë apo lejojnë përdorimin e vlerave të drejta në matjen e pasurive apo detyrimeve. Megjithatë, jo gjithmonë ka patur konsistencë ndërmjet këtyre standardeve lidhur me metodën me të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. SNRF 13 *Vlerat e drejta* është publikuar në maj 2011 si një përpjekje për të rregulluar këtë problem. SNRF-ja ka për qëllim të definoj vlerën e drejtë, krijoj një kornizë për matjen e vlerave të drejta, dhe standardizoj shpalosjet për përdorimin e vlerave të drejta nga entitetet në pasqyrat e tyre financiare. Nuk tenton të japë udhëzim lidhur me përdorimin e shifrave rezultuese të vlerave të drejta, duke ia lënë këtë standardeve përkatëse që kanë të bëjnë me atë pasuri apo detyrim.

SNRF 13 e bën të qartë që vlera e drejtë është e bazuar në treg e jo specifike për entitetin. Andaj qëllimet e një entiteti lidhur me pasurinë apo detyrimin nuk janë relevante në përcaktimin e vlerës së drejtë.

Albina sh.p.k është një kompani investuese e cila mban një portofolio të letrave me vlerë të lidhura me tregun e patundshmërive në Shqipëri. Informatat në vijim janë në dispozicion me 31 korrik 2016 lidhur me këtë portofolio:

- Portofolio ka kushtuar €13 milion 2 vite më parë.
 - Në përgjithësi pranohet se çmimet e patundshmërive në Shqipëri kanë rënë për 20-30% gjatë 2 viteve të kaluara.
 - Portofolio e letrave me vlerë e mbajtur nga Albina sh.p.k është e vështirë të vlerësohet, pasi që nuk ka ndonjë treg aktiv. Megjithatë, ka marrë një ofertë prej €2.6 milion për këtë portofolio nga një investitor. Nuk ka për qëllim ta pranoj këtë ofertë edhe pse disa kompani të ngjajshme kanë pranuar ofertat nga ky investitor për shkak të vështirësive financiare.
 - Në një shitje normale në klimën aktuale mundet me arsyeshmeri të pritët që të sjell të ardhura prej €6 milion, bazuar në analizën e transaksioneve për pasuri të ngjajshme.
 - Modeli i vlerësimit të Albina sh.p.k sugjeron që tregu i patundshmërive në Shqipëri do të rikuperohet, dhe pret që portofolio do të gjeneroj €12 milion (në vlerën e tanishme) përgjatë tre viteve të ardhshme. **Kërkohet:**
- (a) **Diskuto kuptimin e termit “Vlera e drejtë” siç është definuar nga SNRF 13 *Vlerat e drejta*. (8 pikë)**
- (b) **Trego hierarkinë 3 niveleshe të propozuar nga SNRF 13 për të vlerësuar inputet informative në matjen e vlerave të drejta. (6 pikë)**
- (c) **Këshillo së me cilën shumë Albina sh.p.k duhat ta paraqes portofolion e saj të investimeve në pasqyrat financiare me 31 korrik 2016, duke supozuar që dëshiron të përdor vlerën e drejtë të matur në pajtim me parimet e SNRF 13. (6 pikë)**
- (Total: 20 pikë)**

Zgjidhja e problemit 4

4.

(a) SNRF 13 definon vlerën e drejtë si çmimi që do të mirrej për të shitur një pasuri apo paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshme ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes (p.sh një çmim dalës).

Definicioni i mësipërm e thekson që vlera e drejtë është matje e bazuar në treg e jo matje specifike për entitetin. Gjatë matjes së vlerës së drejtë, një entitet përdor supozimin që pjesëmarrësit në treg do të përdornin gjatë vendsojës së çmimit të pasurisë apo detyrimit nën kushtet aktuale të tregut, përfshirë supozimet për rrezikun. Si rezultat, qëllimet e një entiteti për të mbajtur një pasuri përmbushur një detyrim nuk është relevant në matjen e vlerës së drejtë.

SNRF shpjegon që matja e vlerës së drejtë i kërkon një entiteti të përcaktoj të mëposhtmet:

- (a) pasurinë apo detyrimin e caktuar që matet;
- (b) për një pasuri jo-financiare, vlera më e lartë dhe më e mirë e përdorimit të pasurisë dhe nëse pasuria përdoret në kombinim me pasuri të tjera apo në baza të vetme;
- (c) tregun në të cilin një transaksion i zakonshëm do të ndodhte për pasurinë apo detyrimin; dhe
- (d) teknikat e duhura të vlerësimit të cilat duhet të përdoren në matjen e vlerës së drejtë. Teknikat e vlerësimit duhet të maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të observueshme dhe minimizojnë inputet jo të observueshme. Këto inpute duhet të jenë konsistente me inputet që do t'i përdorte një pjesëmarrës në treg në vëndosjen e çmimit të pasurisë apo detyrimit.

(b) Për të rritur konsistencën dhe krahasueshmërinë në matjet e vlerës së drejtë dhe shpalosjet përkatëse, SNRF vendos hierarkinë e vlerës së drejtë që kategorizon tre nivelet e të inputeve në teknikat e vlerësimit të përdorura në matjen e vlerës së drejtë. Hierarkia e vlerës së drejtë i jep prioritet më të lartë çmimeve të kuotuar (pakorigjuara) në tregje aktive për pasuri ose detyrime identike (inputet e nivelit 1) dhe prioritetin më të ulët për inputet e paobservueshme (inputet e nivelit 3).

Inputet e nivelit 1 janë çmimet e kuotuar (pakorigjuara) në tregjet aktive për pasuri ose detyrime të ngjajshme në të cilat entiteti ka qasje në datën e matjes.

Inputet e nivelit 2 janë inpute të tjera nga çmimet e kuotuar të përfshira në nivelin 1 të cilat janë të observueshme për pasurinë ose detyrimin, ose direkt ose indirekt.

Inputet e nivelit 3 janë inpute të paobservueshme për pasurinë apo detyrimin.

(c) Ka një numër të vlerave potenciale që do të mund të përdreshin. Megjithatë jo të gjitha janë të kualitetit të njëjtë.

Ka një ofertë për pasurinë prej €2.6 milion. Megjithatë Albina sh.p.k nuk ka për qëllim ta pranoj këtë ofertë, pra nuk është një çmim i tregut aktiv.

Një shitje e zakonshme pritet të sjellë të ardhura prej €6 milion. Te kjo shifër është arritur pas analizimit të transaksioneve në pasuri të ngjajshme. Andaj duket se kualifikohet si input i nivelit 2, dhe duket e arsyeshme të përdoret si bazë e vlerësimit.

Modelet e vlerësimit janë niveli 3, pasi që janë të paobservueshme. Andaj janë më inferiore se inputet e nivelit 2. Megjithatë, fakti që modelet duket se po parashikojnë një rikuperim sugjeron që vlerësimi i përcaktuar nga ato nuk do të ishte i arritshëm në tregun aktual. Andaj kjo vlerë nuk do të përmbushte përkufizimin e vlerës së drejtë sipas SNRF 13. Andaj, vlerësimi më i mirë i vlerës së drejtë në këtë rast do të ishte €6 milion.

Problemi 5

Informatat në vijim kanë të bëjnë me Pambuk Shqipëria sh.p.k për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016:

- (a) Stoqet përfshijnë 4,000 ton të pambukut të cilat janë blerë me 1 prill 2016 me një kosto prej €6,200 për ton. Me qëllim të mbrojtjes ndaj luhatjeve të pafavorshme të çmimit të pambukut në çmimet e produkteve të saj, Pambuk Shqipëria sh.p.k hyri në një marrëveshje gjashtë mujore në ditën e njejtë për të derguar 4,000 ton me një çmim prej €6,300 për ton. Në fund të viti me 30 qershor 2016, çmimi i tregut të pambukut (aktual) ishte €5,500 për ton dhe çmimi i ardhshëm për dergim në shtator ishte €5,550 për ton.

Të gjitha kushtet e nevojshme për kontabilitetin e mbrojtjes janë plotësuar.

- (b) Me 1 korrik 2015, 2 milion obligacione të konvertueshme prej €100 secila janë emetuar. Secili obligacion është i konvertueshëm në 25 aksione të zakonshme prej €10 secila me 30 qershor 2018. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore në fund të vitit prej 8% në vit. Në datën e emetimit, interesi në treg për borxh të ngjajshëm pa opcionin e konvertimit ishte 11% në vit. Megjithatë, duke llogaritur shpenzimin prej € 4 milion, të shkaktuar për emetimin e aksioneve, norma efektive e interesit u rrit në 11.81%.

Faktorët e skontimi	8%	11%
1 vit	0.9259	0.9009
2 vite	0.8573	0.8116
3 vite	0.7938	0.7312

Kërkohet:

Përgaditi hyrjet në ditar për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016 për të regjistruar transaksionin mësipër. (Trego të gjitha llogaritjet e nevojshme) (8 pikë)

- (c) Me 1 tetor 2015 Mevlana sh.p.k urdhëroi një sasi të stoqeve nga një furnitor valuta funksionale e të cilit ishte USD. Çmimi i dakorduar i blerjes ishte \$40,000. Stoqet janë dërguar me 1 dhjetor 2015 dhe pagesa është bërë me 31 janar 2016. Gjysma e stoqeve është shitur para 31 mars 2016. Kurset përkatëse të këmbimit janë si në vijim: (EUR për USD).

1 tetor 2015 – €6,200 për \$1
1 dhjetor 2015 – €6,300 për \$1
31 janar 2016 – €6,400 për \$1
31 mars 2016 – €6,500 për \$1

Mevlana sh.p.k nuk tentoi të mbrohej nga rreziku i kursit të këmbimit që rrjedh nga blerja e stoqeve të denominuara në Euro.

Kërkohet:

Trego ekstraktet përkatëse të cilat tregojnë se si ky transaksion do të raportohet në pasqyrën e pozitës financiare të Mevlana sh.p.k me 31 mars 2016 dhe në pasqyrën e fitimit ose humbjës dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 mars 2016. Jepni sqarime të cilat i konsideroni të nevojshme (6 pikë)

- d) Frutelia sh.p.k bleu një makinë me 1 dhjetor 2014 në Shtetet e Bashkuara me një kosto prej 360,000 USD. Makina ishte për linjën e re të biznesit të shitjes së frutave të terur. Me 30 nëntor 2015, makina ishte rivlerësuar në €159,000. Megjithatë, kompania, deri me 30 nëntor 2016, perjetoi konkurrencë të fortë nga konkurrentët e rinj në këtë lloj biznesi. Kjo detyroi drejtorët e Frutelia sh.p.k të rishikojnë makinën për ndonjë humbje nga dëmtimi me 30 nëntor 2016. Shuma e saj e rikuperueshme ishte €102,000 në atë datë.

Makina zhvlerësohet me 25% në vit në baza drejtvizore. Nuk ka vlerë të mbetur. Për më tepër, Frutelia sh.p.k ka një politikë të transferimit të ndonjë teprice të rivlerësimit të realizuar tek fitimet e mbajtura. Valuta funksionale dhe raportuese e Frutelia sh.p.k është Euro. Këto janë kurset përkatëse të këmbimit:

	Euro për USD
1 dhjetor 2014	€0.5000
30 nëntor 2015	€0.5600
30 nëntor 2016	€0.5800

Shënim: Supozo që 360,000 USD kanë përfshirë të gjitha kostot relavante që kanë të bëjnë me pagesat doganore të pa-kthyeshme, transaportin dhe instalimin.

Kërkohet:

Shpjego se si ky transaksion do të kontabilizohet në pasqyrat financiare të Frutelia sh.p.k për vitet deri me 30 nëntor 2015 dhe 30 nëntor 2016.

(6 pikë)

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 5

5. (a)

Data	Përshkrimi	D €	K €
01 korrik 16	Stoqet (4,000 × €6,200) Banka / Kreditori	24,800,000	24,800,000

(Regjistro blerjen e stoqeve)

Shënim:

Kontrata për të ardhmen ka vlerë zero në datën kur bëhet, andaj nuk ka regjistrim në pasqyrat financiare.

30 qershor 16	Pasuri financiare (4,000 × €750) Fitimi ose humbja (fitimi nga mbrojtja) Stoqet (4,000 × €700)	3,000,000	200,000 2,800,000
---------------	--	-----------	----------------------

(Regjistro neto përfitimin nga mbrojtja në levizjet e çmimeve të stoqeve dhe kontratat për të ardhmen)

(b)

01 korrik 15	Paraja (200 – 4) Obligacionet (LL-1) Ekuiteti (LL-1)	196,000,000	181,630,000 14,370,000
--------------	--	-------------	---------------------------

(Regjistro arkëtimet nga emetimi i obligacioneve në pajtim me SNK 32)

30 qershor 16	Shpenzimet e interesit (181.63 × 11.81%) Obligacionet (balancues) Paraja (€200 × 8%)	21,450,000	5,450,000 16,000,000
---------------	--	------------	-------------------------

(Njihe shpeznimin e interesit për vitin)

LL-1: përcaktimi i komponentit të detyrimit dhe ekuitetit

Skonto rrjedhat e parasë me 11%

Vlera e tanishme e interesit në fund të:	€ në milion
30 qershor 16 (€200 milion × 8%) × [1 ÷ (1+0.11)]	14.41
30 qershor 17 (€200 milion × 8%) × [1 ÷ (1+0.11) ²]	12.99
30 qershor 18 (€200 milion × 8%) × [1 ÷ (1+0.11) ³]	11.70
Vlera e tanishme e kryegjësë	
30 qershor 18 [€200 milion × (1 ÷ (1+0.11) ³)]	146.24
Total komponenti i detyrimit	185.34
Total komponenti i ekuitetit (balancues) 200-185.34	14.66

Arkëtimet nga emetimi 200.00

Aloko kostot e emetimit

	Detyrim	Ekuiteti	Total
€ në milion			
Arkëtimet	185.34	14.66	200.00
Kosto e emetimit	<u>(3.71)</u>	<u>(0.29)</u>	<u>(4.00)</u>
	181.63	14.37	196.00

c)

Pasqyra e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar me 31 mars 2016 (Ekstraktet)

	€'m
Kosto e shitjeve (€252m x 50%)	126
Humbja nga këmbimi në pagesën e të pagueshmeve tregtare	4
Pasqyra e pozitës financiare me 31 mars 2016 (Ekstraktet)	€'m
Stoqet	126

Detyrimi për të paguar mallrat lind me 1 dhjetor 2015 kur mallrat dergohen. Në këtë datë €252m (40,000 x 6,300) debitohet tek stoqet dhe kreditohet te llogaritë e pagueshme tregtare.

Kur detyrimi është shlyer 40,000 USD kushtuan €256m (40,000 x 6,400) andaj një humbje nga këmbimi prej €4m (€256m - €252m) njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjës.

Stoqet janë pasuri jomonetare prandaj maten duke përdorur kursin e këmbimit në fuqi kur janë blerë. Nuk ka diferenca në kursin e këmbimit.

d) Makina

Makineria fillimisht do të regjistrohet sipas vlerës €180,000 (L11) me 1 dhjetor 2014. Me 30 nëntor 2015, vlera e saj është €159,000. Kjo është pas zhvlerësimit për vitin deri me 30 nëntor 2015 prej €45,000 (L11) dhe tepricës së rivlerësimit prej €24,000 (L11). Zhvlerësimi do të shpenzohet përderisa teprica e rivlerësimit do të kreditohet te të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2015. Shuma e rivlerësuar prej €159,000 do të zhvlerësohet përgjatë jëtës së mbetur ekonomike prej 3 viteve. Kjo rezulton me zhvlerësim prej €53,000 që do të shpenzohet në vitin e përfunduar me 30 nëntor 2016. Humbja nga dëmtimi prej €4,000 nuk do të shpenzohet por do të zbitet nga teprica e rivlerësimit. Transferi tek fitimet e mbajtura prej €8,000 i kreditohet fitimeve të mbajtura dhe debitohet tepricës së rivlerësimit. Kjo e le saldon e tepricës së rivlerësimit në shume prej €12,000 me 30 nëntor 2016. Makina do të tregohet me shumem e rikuperueshme prej €102,000 me 30 nëntor 2016.

L11 Makineria

	€'000
1 dhjetor 2014: kosto 360,000 USD x €0.50	180
Zhvl 25% x €0.18m f/v 30 nëntor 2015	<u>(45)</u>
Vlera bartëse me 30 nëntor 2015	135
Teprica e rivlerësimit (shif. bal)	<u>24</u>
Shuma e rivlerësuar me 30 nëntor 2015	159
Zhvl 1/3 x €0.159m f/v 30 nëntor 2016	<u>(53)</u>
Vlera bartëse me 30 nëntor 2016	106
Humbja nga dëmtimi (shif. bal)	<u>(4)</u>
Shuma e rikuperueshme me 30 nëntor 2016	102
Teprica e rivlerësimit	24
Humbja nga dëmtimi	(4)
Transferuar tek fitimet e mbajtura 1/3 x 0.024	<u>(8)</u>
Saldo me 30 nëntor 2016	12